



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e katerdhjet e njitë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 28.08.2025, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

1. Enver Rugova, LDK;
2. Hajrush Shoshi, LDK;
3. Faruk Kabashi, LDK;
4. Haki Podrimaj, LDK;
5. Faik Alushaj, LDK;
6. Ruzhdi Metaj, LDK;
7. Veton Kurtaj, LDK;
8. Arta Balaj, LDK;
9. Liridona Lajçi, LDK;
10. Valbona Demaj, LDK;
11. Njomza Demaj, LDK;
12. Arianit Selmanaj LDK;
13. Agron Gashi, AAK;
14. Ardita Idrizaj, AAK;
15. Fjolla Ukaj, AAK;
16. Ajshe Metaj, AAK;
17. Negjdet Ramaj, AAK;
18. Florin Dreshaj, VV;
19. Niman Beqiraj, VV;
20. Floriana Maxharraj, VV;
21. Lavdiqe Bujupaj, VV;
22. Visar Haxhijaj, PDK;
23. Era Visoqi, PDK;
24. Djula Karisik, GIBI;

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana ,përfaqësues të GIZI-it (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1") (Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.facebook.com/Radiofontana.org/videos/1125875026086122>

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Procesverbali

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.
Hap punimet për mbledhjen e katerdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 24 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Rishqyrtimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinaeve (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan, dhe Junik 2025-2035.
4. Rishqyrtimi i vendimit 00Nr.149/2025 i dates 31.07.2025 për destinimin e lokacionit për varreza të fshatit Rakosh nga prona e paluajtshme e komunës.
5. Rishqyrtimi i vendimit 00Nr.150/2025 I dates 31.07.2025 për destinimin e lokacionit për varreza të fshatit Zhakov nga prona e paluajtshme e komunës.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Aprovimit të kandidatve për komisionin në përzgjedhjen e drejtorve/zv drejtorëve,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit – dua te ju njoftoj që procesverbalinnga mbledhja e kaluar nuk kemi mundur ta pergatisim sepse kemi pasur shumë probleme teknike kështu që ju kerkojmi faljen procesverbalin do ta keni mbledhjen e ardhshme.

Po ashtu ju njoftoj për piken 4 dhe 5 te cilat propozoj që ti hiqim nga rendi i dites pasi që jemi konsultuar edhe me ministrin që keto dy prona ne nuk do ti rishqyrtojmi të mbeten ashtu.

A ka dikush diçka tjeter rreth ketijë rendi te ditës?

Nexhdet Ramaj - përshendet të gjithë të pranishmit, keto prona që ne po i hjekim prej rendit të ditës dua ta di a do të jen keto prona në shfrytëzim të banorve të asaj zone dhe a mund ti kryejn ritete fetare.

Kam edhe një shqetesim pse nuk e kemi rregulloren për emrimin e objekteve komunale si pikë të rendit të ditës ka qen premtim i kryetarit për kete mandat, ka qen mirë që kete rregullore ta perfundojm ne mos tua lëm mandatin tjetër?

Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati - përshendet të gjithë të pranishmit, ben sqarimin rreth ketyre pronave dhe rregullores.

Florin Dreshaj - përshendet të gjithë të pranishmit, mendoj që ato dy pika të rendit të ditës nuk duhet me u hjek, ata e kan derguar arsyetimin pse i kan kthly apo tash para zgjedhjeve po doni me u tregu të fort. Ata zyrtar që i kan kontrollu ato vendime nuk janë te VV ata janë edhe te partive tjera keto duhet ti lëm si pika të rendit të ditës të diskutojmi kur ti vjen rendi tyre.

Kryesuesi i Kuvendit - sqaron.

Kam edhe një propozim me e shtu një pikë të rendit të ditës ku i ka kalu të gjitha fazat qe kerkohen me ligj: Planin Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025-2027 kerkoj që kjo pikë të përfshihet në rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Hedh në votim që pika 4 te hiqet nga rendi i ditës:

Kushë që te hiqet nga rendi i ditës

20 vota për dhe 4 kunder miratohet te hiqet nga rendi i ditës pika 4.

Vazhdojm, Hedh në votim që pika 5 te hiqet nga rendi i ditës:

Kushë që te hiqet nga rendi i ditës

20 vota për dhe 4 kunder miratohet te hiqet nga rendi i ditës pika 5.

24 anëtar prezent në sall.

Hedh në votim propozimin

kush është të hiqen nga rendi i ditës pika 4 dhe 5

Miratohet unanim 25 anëtar të Kuvendit prezent.

Florin Dreshaj - piken që kerkuat ta shtoni është pik shumë e qelluar por ne nuk kemi material as skemi kurgjo nuk dimi për qka dojm me votu.

Kryesuesi i Kuvendit - nuk ka problem kjo mund te jetë edhe për mbledhjen tjetër so problem pasi qe edhe një mbledhje duhet me majt për buxhet.

Niman Beqiraj - unë jam që kjo pik te shtyhet për mbledhjen tjetër, për shkak qe t137 kontribuojmi edhe ne asambleistat në këtë pikë.

Kryesues i Kuvendit – nuk po e shtime pra këtë pike vazhdojmi.

Hedh në votim rendin e ditës për sot, kush është të votohet rendi i ditës me këto propozime?

Konstatojmë që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 4 abstenim miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungon Andi Xhuraj, Nexhmedin Balaj dhe Arian Shatri.

Të pranishëm në mbledhje janë 24 anëtarë të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit – vazhdojm me piken e tret te rendit te dites Rishqyrtimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan, dhe Junik 2025-2035, sqaron rreth kësaj pike materialin e keni shkikuar .

Ajshe Metaj - përshendet të pranishmit, u tha se janë thirrur në me shumë ligje se që duhet. Shtrohet pyetja a është cdo kush me formu ligje e udhezime të ndryshme apo duhet me qen të kordinuara në një nivel se kjo po është pak banale sepse dikush është përgjegjes për keto. A është dikush përgjegjes për keto.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron.

Florin Dreshaj – kjo është një shqetsim se kaluan 4 vite të kesaj ligjislature dhe me shumë se gjysa e kerkesave tona drejtuar MAPL-së për ligjshmeri po kthehen sit ë gabuara.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Duxhet e Financa z. Genc Ademaj – përshendet të pranishmit, bën sqarimin.

Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim rendin e ditës për sot, kush është të votohet rendi i ditës me këto propozime?

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 23 vota pro 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet unanimit.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me piken e gjashtë të rendit të dites: Shqyrtimi dhe miratimi i Aprovimit të kandidatve për komisionin në përzgjedhjen e drejtorve/zv drejtorëve, Materialin e keni pasur a ka dikudh diqka?

Largohet nga salla Faruk Kabashi për shkak të konfliktit të interesit.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - përshendet të pranishmit, bën prezantimin dhe sqarimin.

Agron Gashi - prej sa antarve ka perberjen ky komision ?

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - është kryetari I këshillit të prindërve dhe një zyrtar nga MA.

Ajshe Metaj - u tha se keta anëtar propozohen nga DKA, kam një pyetje për drejtorin e kemi pasur një person tjetër në vend të Mimozes du atë di a e ka pasur përgatitjen e njejt apo pse I rat pishmon e ndrrut kandidatin.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - sqaron.

Hajrush Shoshi - përshendet të pranishmit dhe, në KPF kam kërkuar Udhezimin Administrativ për zgjedhjen e këtij komisioni.

Florin Dreshaj - është pak shqetësuese nuk është kotë ajo që për çdo konkur duhet të emrohet një komision I rip rap se prap po emrohen çdo here të njejt. Drejtori ka thënë se ka ndermend me e depolitizuar arsimin e kjo po shihet që është puro politike është një grup I ngusht që vendosin kush me u bë drejtor sa here po kemi keso raste duhet dikush nga asambleistet të del jasht sepse janë familjaret e tyre nuk dua të ofendoj dike se kam respect për ta pork a edhe tjer që kan pervoj edhe me shumë edhe përgatitjen.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - sqaron.

Agron Gashi - komisioni duhet të jete me i kualifikuar se sa kandidatet qe aplikojn me sa kam njohuri unë ka persona që aplikojn që kanë eksperienc dhe kualifikim me te lart se komisioni.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj - sqaron.

Kryesuesi i Kuvendit a ka dikush tjeter diqka, atehere po votojm:

Konstatohet që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 16 vota pro 1 kundër dhe 6 abstenim miratohet unanim

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e fundit të rendit të dites të ndryshme:

Lavdiqe Bujupaj - përshendet të pranishmitedhe, kam një kerkes që familjet e Osmon dhe Nezir Jahaj nga Shushica e Ulet kanë pasur një dem të madh në muajin Majë nga vershimet dhe si pasoj kanë pasur dëme të medha materiale dhe traum në familje keto familje kan kerkuar nga komuna disa here që ti dalin në ndihm komuna me ndertimin e një muri mbrojtës në menyr që situatë të mos perseritet duke pasur parasysh se tani jemi afer vjeshtes dhe vershimet janë shumë me të medha. Kanë kerkuar që muri te kete lartësin 80 santin afer shtepive dhe mbaron me 40 santin arsyeja e ndertimit te ketij muri është qe uji most ë deportoj në shtepi, mirë po ende nga komuna nuk kanë marr pergjegje te dy kryefamiljare te cilet kan ardhur disa here në komunë për te kerkuar ndihmë. komuna ende nuk është pergjigjur kostoja e ketijë durri është dikur rreth 2700 euro ku per keto familje është e pa perballueshme dhe sinqerisht kerkoj nga komuna që ta analizojn dhe ta mundesojn ndertimin e ketijë muri në menyr që të mos perseritet situatë e njejtë.

Niman Beqiraj – dua te diskutoj për disa projekte të fshatit Vrellë te cilat janë buxhetuar dhe nuk janë perfunduar,

Ndriqimi Publik prej 55mijë euro, ndertimi i trotuarit Lubozhd – Vrellë, faza e 2te e vijes se “Ahmet Ages,, rregullimi I trotuareve te tjera në zona urbane që kane qenë te ndara 70 mijë, ndertimi I shtepis se cultures dhe parku në fshatin Vrellë prej 160mijë euro, renovimi I nyjeve sanitare në shkollen fillore prej 25 mijë euro, betonimi i kanalit t; uitjes Stupe – Bollopola në Vrellë, betonimi i kanalit lagja “Blakaj,, në Vrellë, betonimi I kanalit te uitjes Vrellë – Studenic, ndertimi I Rrugës “Halil Osmani,, në Vrellë dhe ndertimi I fushes së varrezave në vrellë ato lartë qe I kemi të rejat port e lagja “Maxharraj, Dreshaj,, kanë qenë te ndara 12 mijëeuro, dhe as një nga keto projekte nuk kanë filluar. A është ndonjera nga keto projekte që ka me shku në suficit?

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj – sqaron rreth pyetjeve për arsim.

Veton Kurtaj - përshendet të pranishmitedhe, kam një kerkes nga një banor i Istogut të Poshtem, Rruga “Solidariteti,, qe lidh Istogun e Poshtem me Dubraven kerkohen disa polisa të shtrir aty sepse shpejtesia e automjete është e madhe dhe ka shumë aksidente.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron.

Negjdet Ramaj – kam pyetje për Kryetarin por te jet në procesverbal dhe mund te me kthej me shkrim, kam një qeshtje shumë serioze lidhur me lapidarin në qendër, lapidari në qendër ne pamje te par duket që është një lapidar i mirë dhe është shumë i mirë, një person i vetëm e ka ber projektimin e tij gjeja në menyr humane pa asnjë shpenzim mirë po i njëjti me kompanin ku punon e ka fitu tenderin dhe i ka mbikëqyr punimet mbi të gjitha ky projekt ka kushtuar 100 e 9 mijë euro, a është shumë e arsyeshme kjo për një lapidar as nuk ka nen kalim as mbikalim as shpronësim ku shuma është 100 e 9 mijë euro, kërkon hetim të thell nga organet kompetente me shumë.

Zjarret e fundit në Gurrakoc po flas për familjen „Bajramaj” që Kryetari e ka shtëpinë afër tyre dua ta pyes a ka arsye për këtë mos përfillje pse nuk i ka gjet 5 min me shku me e vizitu kete familje i vetmi një drejtor i Administrates i ka vizituar tjert nuk kan shkuar hiq as një drejtor as Kryetari te paktën me ju jep një ndihm morale pasi qe ata janë përballur me një rrezik të madh per jetën dhe për pasurin e tyre pasi që gjysma nga pasuria e tyre është shuar.

Kam pyetje për këmbimin e pronës me “Ismet Halimaj,, te stadiumin “Demush Mavraj,, aty shkrun marrveshja për 90 ditë te zbatohet marrveshja pronari i tokës deklaroi se nuk ka s një hap të marr?

Floriana Maxharraj – kam një shqetësim ose një kërkesa për ju, turizmi në lugun e butë po zhvillohet mirë po qytetaret tanë apo blegtoret qe e ushtrojnë veprimtarin e tyre janë të shqetësuar nga ngasjet e motoçikletave sidomos gjatë ditëve të fundjavës ata kërkojnë që këto dy ditë të monitorohen nga autoritetet përkatëse në mënyra që te mbrohet siguria dhe rendi.

Kryesuesi i Kuvendit – sqaron.

Ajshe Metaj – dy pyetje për drejtorin e Arsimit: deri ku ka shkuar ndërtimi i sallës së sportit në gjimnaz? Momentalisht punimet nuk janë duke u zhvilluar, kur do të fillojnë. Çerdhja afër Policisë kanë mbet ato mure s’di qysh përngjajnë sa po je në gjendje me bë presion, çerdhet e fëmijëve janë të domosdoshme si në çdo qytet tjetër me mujt me vazhdua mos me mete ashtu me gjasë që vazhdohet kështu ato mure kanë me u rrënuar kërkoj një përgjigje nga ju.

Drejtori i Arsimit, z. Naim Behlulaj – sqaron rreth pyetjeve.

Fjolla Ukaj – kam një çështje se e ngri kohë pas kohe rruga “Mehmet Gjevori,, të cilët e kanë një problem të vazhdueshëm sa herë që uji që pastrohen nga pazënat e “Termalit,, atë lagje e merr komplet uji, sepse gëlqerja qe del i nxin komplet ata gypat që janë a ka mundësi me bë ndonjë zgjidhje për ta sepse vërtet është alarmante krejt muret e shtëpive kanë nis me u prish. Prej 6 gushtit ja kam dërguar drejtorit edhe videot edhe gjendjen faktike qysh është dhe nuk e kam marr një përgjigj.

Lavdie Bujupaj – banoret e mivades janë të shqetësuar për arsye që ende vazhdojn të mos kenë ujë kur ka me u përfunduar brana e ujit për mbivaden ata njerëz janë pa ujë, me disa kanata duke u munduar se nuk janë as pak higjienikë dhe janë të rrezikuar

edhe për shëndet, sa mund të ju japim shpresa atyre njerëzve kur ka me pas ujë. Ata po obligohen ta ndërrojnë vendbanimin për arsye se nuk kanë ujë.

Kryesuesi i Kuvendit - sqaron.

Niman Beqiraj - dua të flas nga cilësia e anëtarit të kuvendit komunal për shkak që Hidro Drini i ka format e veta si komunikon. Hidro Drini ende nuk e ka mor në menaxhim projektin e mbi vades projekti ende nuk ka përfundua dhe nuk e kemi në menaxhim.

Kryesuesi i Kuvendit- e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme.
Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë,
Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:30

Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj

Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova

